

VENDIM
Nr. 735, datë 15.11.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I SEGMENTIT
RRUGOR ‘PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI ‘SHQIPONJA’”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, shifra “... 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekë ...”, zëvendësohet me “... 1 382 942 033.52 (një miliard e treqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy) lekë ...”.

b) Pika 4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 382 942 033.52 (një miliard e treqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekë, nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 158 067 603.10 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tre pikë dhjetë) lekë, nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.

c) Në pikën 5, shifra “... 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 100 000 (njëqind mijë lekë)...”.

ç) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.04.2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PALLATI ME SHIGJETA – RRETH RROTULLIMI “SHQIPONJA””, I NDRYSHUAR

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT pasurinë sipas zvrpp) (mbi										VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi		Ndërtesë total		
								Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m2)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2)	Vlera (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)	Vlera sipas Preventivit (lekë)	Sip.Nd. konf.nga ZVRPP (m2)		
1	Dashi Eljon	Alo Dashi	Satko Satko	8210	7/476 7/475	Ndërtesë	479.50				479.50	18,443,943.21	18,443,943.21	18,443,943.21	Konfirmuar nga ZVRPP Tirane
2	Flamur	Matosh	Dajçi	2679	440/327+1-N1 440/327+1-N2 440/327+1-1 440/327+1-2 440/327+1-3 440/327+1-B	Ndërtesë	2,397.30	1,146.60	53,500.00	61,343,100.00	1,250.70	35,444.83	44,330,852.29	105,673,952.29	Konfirmuar nga ZVRPP Tirane
3	Skender	Isuf	Doda	2679	440/298	Ndërtesë	593.50	593.50			593.50	20,630,105.49	20,630,105.49	20,630,105.49	Konfirmuar nga ZVRPP Tirane
4	Ismail	Xhetan	Nesimi	2679	440/337	Ndërtesë	201.20	201.20	53,500.00	10,764,200.00	50.50	1,314,274.19	12,078,474.19	12,078,474.19	Konfirmuar nga ZVRPP Tirane
5	Leonard	Ali	Muja	8210	7/6-ND	Ndërtesë	130.30					1,241,127.92	1,241,127.92	1,241,127.92	Konfirmuar nga ZVRPP Tirane
	S H U M A						3,801.80	1,941.30		72,107,300.00	2,374.20	41,664,895.64		158,067,603.10	